



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kacanik
Republic of Kosovo
Kacanik



Komuna e Kaçanikut
Opština
Municipal

Nr. 01/104/02 - 12132

24.05.2022

RAPORT rreth debatit publik mbi draft rregulloren nr.03./2022 për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive në Komunën e Kaçanikut

Propozimet e qytetarëve nga ky debat publik:

Përpos personave me aftësi të veçanta të hyjnë edhe, organizatat dhe klubet sportive të Personave me Aftësi të Kufizuara ngase për momentin në komunën tonë nuk kemi këso klube por që po mendojmë që në të ardhmen mundemi të kemi, kështu që rregullorja duhet ta ketë edhe këtë plotësim.

Të ceket në nenin 7 pika 1 që pala e interesuar për shfrytëzim të palestrës duhet të paraqes kërkesë së paku 3 ditë pune para, ngase mundë të qëlloj vikend dhe krijohet keqkuptim. Gjithashtu kërkesat duhet të bëhen në zyrën e pritjes së objektit të komunës, të protokolohen dhe të përcillen në DKRS. Në kuadër të Drejtorisë së Administratës është edhe personi përgjegjës që i përcjellë kërkesat në destinacionin që pala e ka drejtuar këtë kërkesë.

Secili klub apo organizatori i aktivitetit duhet të parashohë se sa afërsisht publik do të ketë në atë event dhe nëse mendohet se do të ketë shumë pjesëmarrës atëherë të njoftojnë edhe Stacionin e Policisë me qëllim që aktiviteti të ketë mbarëvajtje.

Nenin 12 pika 1.7. pagesa prej 100 euro për klubet sportive që nuk janë të komunës së Kaçanikut, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të interesuara të shfrytëzojnë Palestrën Sportive në Kaçanik, është e lartë ngase po bazohemi në atë se klubit i basketbollit i komunës tonë ndeshjet i ka zhvilluar në Ferizaj dhe asnjëherë nuk na kanë obliguar për të paguar sallën.

Në pjesën ku bëhet fjalë rrëth hyrjes në palestër për të përcjellur ndonjë aktivitet mendoj se klubet duhet të kenë triska me një llogo të komunës apo ndonjë llogo tjetër me qëllim që të mos keqpërdoret , dhe organizimin e hyrjes së publikut në sallë duhet ta merr vet organizatori i atij aktiviteti. Fjala është për hyrje pa pagesë për vullnetarët e rindë, ndonjë nxënësi me suksese të veçanta apo ndonjë aktivisti që komuna mendon se duhet të ju bëhet një e mirë , pasi që ekziston edhe ligji për vullnetarizëm që ju mundëson benifite nga institucioni, gjithashtu duhet të precizohet në rregullore edhe pjesëmarra si shikues e fëmijëve që përpos në aktiviteti edhe si shikues të jenë prezent vetëm në mbikëqyrje të prindit apo trajnerit .

Ndërsa me postë elektronike nuk kemi pranuar asnjë koment në lidhje me draft rregulloren.

Grupi punues shqyrtoi kërkesat e dalura nga ky debat publik dhe e pa të arsyeshme që të njejtat i plotësoi në Draft rregulloren e cila më pas më të gjitha këto ndryshime u votua unanimisht në kuvend.

Drejtoresha e DKRS

Hafize Sallahu

